

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Topi i Artë 2026, Mbappe, Yamal, Kane dhe Rodri mes pretendentëve kryesorë
ADRESA	https://albeu.com/sport/topi-i-arte-2026-mbappe-yamal-kane-dhe-rodri-mes-pretendenteve-kryesore/1015533/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 08:23:52 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 08:20:16 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9bf09f00ce61ede124e32b029205f8b0358ae7d8e650548e861448e382d1e2c1
TEKSTI	1b4619c7e2007b0f878ecb8a02cbd5f9a5e28a6d4295e3e8474d7abb572ce593
PAMJA	11c7267ce938577b23643ae51600cd22df42805a14b8542966c7e055e65de752

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6586f3cfd2ec10d88a291c46624f6392a466bb839fcb377b0c170530e7a12090
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	08125200eaf71731bdbb8a1cab166a4681f18204dc61aa429d5ceda9de8c2ea9
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6586f3cfd2ec10d88a291c46624f6392a466bb839fcb377b0c170530e7a12090>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Topi i Artë 2026, Mbappe, Yamal, Kane dhe Rodri mes pretendentëve kryesorë



Gara për çmimin e futbollitit më të mirë të sezonit pritet të jetë ndër më të fortat e viteve të fundit, pasi disa prej yjeve kryesorë kanë arsye bindëse për të synuar triumfin.

Fituesi i Topit të Artë 2026 do të shpallet më 26 tetor, gjatë ceremonisë që do të organizohet në "London Palladium Theatre" në Londër. Ky edicion do të jetë i veçantë, sepse përkon me 70-vjetorin e trofeut prestigjioz.

Në vlerësim do të përfshihen paraqitjet gjatë gjithë sezonit, përkatësisht nga 3 gushti 2025 deri më 19 korrik 2026, së bashku me performancat në Kupën e Botës. Përcaktimi i fituesit do të mbështetet në tri kritere zyrtare.

Performanca individuale është kriteri kryesor për Topin e Artë

Sipas rregullores së çmimit, kriteret ndiqen sipas një radhe të përcaktuar. Në krye qëndron paraqitja individuale, ku vëmendje e posaçme i kushtohet ndikimit të lojtarit dhe aftësisë së tij për të vendosur ndeshjet.

Rezultatet e skuadrës dhe trofetë e fituar renditen në vendin e dytë, kurse kriteri i fundit përfshin klasën e futbollitit dhe respektimin e lojës së ndershme.

Për këtë arsye, triumfi në Ligën e Kampionëve, La Liga apo Kupën e Botës nuk mjafton vetvetiu për ta garantuar Topin e Artë.

Sukseset kolektive kanë rëndësi në procesin e votimit, por juria duhet të përcaktojë fillimisht se cili lojtar ka shkëlqyer më shumë përgjatë të gjithë periudhës së vlerësimit dhe kush ka pasur ndikimin më të madh në përballjet vendimtare.

Edhe mënyra e votimit është e rregulluar në detaje. Për futbollistit më të mirë votojnë gazetarë të specializuar nga 100 shtetet e para të renditjes së FIFA-s, me vetëm një përfaqësues nga secili vend.

të fundit /



FOTOLAJM/ Deputetët e opozitës ngjisin fotot e Belinda Ballukut m...



Topi i Artë 2026, Mbappe, Yamal, Kane dhe Rodri mes...



Konferenca e Kryetarëve refuzon kërkesën e opozitës ...



Ristoska: Çdo çështje ndaj LSDM-së do ta kisha hapur pa hezitim



Pejë, ngrihet aktakuzë për mashtrim në prokurim publik dhe...



BIRN: Beteja digjitale e "Revolucionit të Flamingove", mes...



Zbulohet arsyeja pse Mbappe, Vinicius dhe Konate fshehën...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Çdo anëtar i jurisë zgjedh dhjetë emra nga lista prej 30 të nominuarish. Lojtarëve të përzgjedhur u ndahen, sipas renditjes, 15, 12, 10, 8, 7, 5, 4, 3, 2 dhe 1 pikë. Topin e Artë e fiton futbollisti që mbledh numrin më të madh të pikëve.

Mbappe, Yamal dhe Kane mbështeten në argumente të ndryshme

Kylian Mbappe hyn në garë me shifra të jashtëzakonshme. Sulmuesi i Real Madridit e mbylli sezonin 2025/26 të La Ligës me 25 gola dhe siguroi trofeun Pichichi. Në Ligën e Kampionëve ai realizoi 15 herë në 11 ndeshje, duke u renditur si golashënuesi më i mirë i turneut.

Francezi spikati edhe në Kupën e Botës, ku shënoi 10 gola dhe fitoi Këpucën e Artë të kompeticionit.

Harry Kane, ndërkohë, regjistroi 61 gola në 51 paraqitje për Bayern Munichun gjatë sezonit të klubeve. Prej tyre, 36 u shënuan në Bundesliga, bilanci që i dha Këpucën e Artë evropiane.

Sulmuesi anglez realizoi edhe 14 gola në Ligën e Kampionëve, ndërsa në Kupën e Botës shënoi gjashtë herë për Anglinë.

Lamine Yamal e ndërton kandidaturën e tij mbi ndërthurjen e shkëlqimit personal me sukseset e skuadrave. Sulmuesi i Barcelonës u zgjodh Lojtari më i Mirë i La Ligës 2025/26, pasi e përfundoi kampionatin me 16 gola dhe 12 asistime.

Kësaj i shtohen triumfi i Barcelonës në La Liga dhe fitorja e Spanjës në Kupën e Botës. Të dyja këto arritje kolektive merren drejtpërdrejt parasysh në kriterin e dytë të votimit për Topin e Artë.

Trofetë nuk mjaftojnë për ta vendosur automatikisht fituesin

Edhe rasti i Rodrit dëshmon se vlerësimi për Topin e Artë nuk kufizohet vetëm te numri i golave apo trofetë e fituar.

Mesfushori u shpall nga FIFA fitues i Topit të Artë të turneut, pasi Spanja triumfoi në Kupën e Botës.

Profilin mbi të cilin mbështetet kandidatura e tij ndryshon nga ai i Mbappes, Kane apo Yamalit, megjithatë vlerësimi bëhet sipas të njëjtave kriteresh.

Në përfundim, fituesi i Topit të Artë nuk zgjidhet përmes një përlogaritjeje të thjeshtë të golave dhe trofeve.

Gazetarët janë të detyruar të analizojnë së pari performancën individuale, më pas arritjet kolektive dhe, në fund, sjelljen sportive.

Emri i fituesit do të mësohet më 26 tetor, kur Londra do të jetë nikoqire e ceremonisë së 70-të të Topit të Artë.

Shtuar më 17.09.2026 10:20

Tags: [BARCELONA](#), [Bayern Munich](#), [Harry Kane](#), [Kylian Mbappe](#), [lamine yamal](#), [real madrid](#), [Rodri](#), [Topi i Artë](#)



Vendimi i Hagës për ish-krerët e UÇK-së, reagon Skender Gega: Asnjë...



Zbulohet arsyeja pse Mbappe, Vinicius dhe Konate fshehën mesazhi...



Granit Xhaka pas vendimit të Hagës: Lufta e tyre ishte për lirinë e atdheut



Java e pestë e Superiores sjell duele të forta, nga beteja në Shkodër te...



Martial synon rikthimin në La Liga, heq dorë nga oferta milionëshe



Luis Diaz shpalos ambiciet e Bayern Munich në Ligën e Kampionëve



Chelsea ndryshon pronësinë: Boehly largohet, Clearlake merr kontrollin ...



Messi arrin kuotën e 100 golave dhe udhëheq Inter Miamin drejt një tjetër...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com |

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.